



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:173715

Datë: 19.09.2022

Numri i dokumentit: 03436053

C.nr.1007/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Kaltrinë Haliti, me bashkëpunëtoresh profesionale Edona Zuzaki, në çështjen kontestimore të paditësit SH.M nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.A avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit– Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar i Lartë Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 1, 189.26€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të mbajtur me datë 18.08.2022, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit SH.M nga Gjilani, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit SH.M nga Gjilani, për shpërblim jubilar për 20 vite përvojë pune apo 75% të një page bazë përkatësisht shumë në lartësi prej 181.26 Euro, për shpenzime të ushqimit ditorë nga 2€ në ditë për periudhën 18.04.2017 deri me 18.04.2020, për 509 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumë prej 1, 018.00 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 199.26 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë shumë në lartësi prej 269 të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë më datë 03.08.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblim jubilar. Në seancën e datës 17.08.2022, e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit SH.M nga Gjilani, për shpërblim jubilar për 20 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj 75% të pagës bazë në shumë prej 181.26 Euro, e që paga bazë e paditësit është 241.68 Euro, ndërsa për shpenzime

të ushqimit ditorë, për periudhën 18.04.2017 deri me 18.04.2020, për 509 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 1, 018 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 259.68 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas pranimit të padisë duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi. Me të cilin e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë, me datë 04.10.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e e paditësit duke shtuar në mes tjerash se Gjykata Themelore në Gjiilan nuk ka kompetencë lëndore lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, e kompetencës është Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje Administrative. Paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në KKAK të datës 18.04.2017, gjersa konsiderojmë se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjiilanit. KKAK bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, tutje kanë theksuar se kësaj kërkesëpadie i mungon baza ligjore sipas Ligjit të punës 03/L-212 neni 20.2. Neni 35.7 i KKAK në fuqi parashihet kompensimi për ditët e pranisë në punë që nënkupton si ditë e plotë e punës që është 8h pune, mbi këtë bazë mungojnë dëshmit nga Shkolla përkatëse për të vërtetuar këtë fakt. Sa i përket shujtave duhet domosdoshmërisht të ketë dëshmi nga insitucioni përkatës që nuk është rregulluar forma e ushqimit brenda institucionit dhe që nuk paguhet ndonjë shtesë për shujtë nga punëdhënësi. Tutje ka shtuar se kjo kërkesë është parashkruar konform Ligjit të Punës nenit 78.1 e gjithashtu lidhur me këtë rast nuk janë shterrur as mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative. Sa i takon ditëve të pranisë në punë konsiderojnë se janë të përfshira më tepër se 185 ditë brenda një viti dhe atë sipas vërtetimit me nr. Prot 191/2021 të datës 11.06.2021 dhe kjo është në kundërshtim me kalendarin shkollor të lëshuar nga MASHTI.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 17.08.2022, përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse i propozuan gjykatës që për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës të kalohet drejtpërdrejtë në seancë kryesore, gjykata e pranoi propozimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ashtu që konform nenit 420.3 të LPK-së, për shkak të ekonomizimit, efikasitetit të procedurës e gjithashtu për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes kaloi drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor të çështjes.

I autorizuari i paditësit si në seancën përgatitore, kryesore po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, e gjithashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë 104€ për përpilim të padisë, 30€ për taksë gjyqësore për padi dhe 135€ për një seancë të mbajtur, në shumë të përgjithshme 269€.

Përfaqësuesi i të paditurës, si në seancën përgatitore, kryesore po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe janë parashkruar

kërkesat konform nenit 353 të LMD dhe nenit 87 të Ligjit të Punës, të për shkak se kanë qenë kërkesa mujore.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale dhe atë: Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar e me numër protokollit 866 e datës 01.09.2015, Vërtetimi me numër protokollit 191/2021 i datës 11.06.2021, Vërtetimi me numër protokollit 192/2021 i datës 11.06.2021, Lista e pagave me numër ...

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar e me protokollit 866 e datës 01.09.2015, vërtetoi faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjiilan, edhe atë duke filluar nga data 01.09.2015 në pozitën punëtor teknik në SHFMU "Selami Hallaçi" në Gjiilan.

Vërtetimi me numër protokollit 191/2021 i datës 11.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi si punëtorë teknik pranë kësaj shkolle ka punuar nga viti 2001, ku edhe në vazhdimësi punon aty.

Nga Vërtetimi me numër protokollit 192/2021 i datës 11.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi nga data 18.04.2017 deri me datë 18.04.2020 ka pasur 509 ditë të pranisë në punë.

Nga Lista e pagave me numër ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka 241.68 Euro.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, konkretisht nenin 35 par. 5, 7 dhe 8 pika 8.3 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Me nenin 35 paragrafi 7 i po kësaj kontrate ka paraparë se *"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditën e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy), euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit e kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim"*, ndërsa neni 35 paragrafi 8 pika 8.1 parasheh: *Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë"* e në rastin konkret paditësi të e paditura konkretisht në SHFMU "Selami Hallaçi" në Gjiilan ka themeluar marrëdhënie pune pa ndërprerë që nga viti 2001, ku edhe në vazhdimësi punon aty, i njëjti i ka mbi 20 vite të përvojës së punës, për gjatë periudhës kohore nga data

17.04.2017 deri me datë 17.04.2020 i ka gjithsej 509 ditë të pranisë në punë, për të cilat nuk i janë kompensuar shujtat ditore, andaj nga të lartëcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënesit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t'i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e Komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. Gjithashtu është i pabazuar edhe pretendimi i të paditurës se në rastin konkret paditësit i mungon baza ligjore pasi që kjo çështje është e rregulluar me Ligjin e punës gjegjësisht neni 90.1,2,3,4,5,6 të po këtij ligji.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës së paditësit, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi padia në gjykatë është parashtruar me datë 03.08.2021, pra pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, andaj nisur nga rrethana të tilla rezultoi se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë para kësaj date, pra, para datës 18.04.2017, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, andaj nga këto arsye rezultoi se padia e paditësit është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpasia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë, duke pas parasysh faktin se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së tij lidhur me kërkesën e parashtruar, e njëjta si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: *“Kreditore në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj, duke pas parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t’ia kompensojë shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se *„Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën, kurse Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e detyrojë të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë për përpilimin e padisë nga avokati shumën prej 104 euro, për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej 30 euro, për përfaqësimin e paditësit nga avokati për një seancë gjyqësore shumën prej 135 euro, apo shumën e përgjithshme prej 269€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 3, 22, 24, 31, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe në nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit nsi dhe nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 1007/21, datë 18.08.2022

Gjyqtarja,
Kaltrinë Haliti

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:173715
Datë: 19.09.2022
Numri i dokumentit: 03436053